



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 5674 prot.

Himarë, më 12.12.2023

PROJEKTVENDIM

Nr. 50 datë, 12.12.2023

“PËR MIRATIMIN E NUMRIT TË PËRGJITHSHËM TË PUNONJËSVE TË
BASHKISË HIMARË PËR VITIN 2024”

Në mbështetje të nenit 54 të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Himarë për vitin 2024, i cili do të jetë 239 punonjës.
2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi do të përballohen nga buxheti i Bashkisë Himarë për vitin 2024.
3. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet *drejtoria e burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse dhe drejtoria e financës, e planifikimit të buxhetit dhe e integritit evropian.*

Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i dryshuar.

KRYETARI I BASHKISË

Jorgo Goro

DREJTORIA JURIDIKE

Klejli Muharremi



Drejtör i DBNJSJM

Andon Xani



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA E BURIMEVE NJËRËZORE DHE SHËRBIMËVE MBËSHTETËSE

Nr. 5874/12 prot.

Himarë, më 12.12.2023

RELACION SQARUES

Lënda: Për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të bashkisë himarë për vitin 2024”

KËSHILLIT BASHKIAK HIMARË

Në zbatim të pikës *dh*, të nenit 54, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, në këtë projektvendim po ju propozojmë për miratim, numrin e përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Himarë, për vitin 2024.

Numri maksimal i punonjësve të Bashkisë Himarë në strukturën organizative është menduar të jetë 239. Numri maksimal i punonjësve është menduar të rritet me 11 punonjës nga numri aktual për arsyen e shtimit të numrit të punonjësve të policisë bashkiake.

Për sa ju parashtruar në këtë relacion, bazuar në kërkesat e nenit 54 të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, kërkojmë miratimin e këtij projektvendimi nga ana e Këshillit Bashkiak.

KRYETARI I BASHKISË

Jorgo Goro



DREJTORIA JURIDIKE

Klejli Muharremi

Drejtor i DBNJSHM

Andon Xani